



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

GJAKOVA



Data/nr:	16.04.2026 <i>01-112102-17934</i>
Për:	Shefqet Shehu, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Gjakovës
CC:	- Të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Gjakovës - Arkivit
Nga:	Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës <i>Ardian Gjini</i>
Lënda:	Propozim vendim për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi



Të nderuar,

Me qëllim të realizimit të përgjegjësiave të Kryetarit të Komunës të cilat rrjedhin nga korniza ligjore dhe aktet nënligjore me të cilat rregullohen të drejtat dhe përgjegjësitë për qeverisje lokale dhe duke u bazuar në nenin 58 pika a dhe h të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenin 7.3 të Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë, nenin 4, dhe 9 pika 1.1 dhe 1.2 e Udhëzimit Administrativ nr. 27./2012 MPB – 03/2012 MAPL, për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, Kryetari i Komunës së Gjakovës me dt: 09.01.2026 e parashtron në Kuvendin e Komunës së Gjakovës këtë;

PROPOZIM VENDIM

I. Kuvendi i Komunës së Gjakovës miraton vendimin për Themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi në Komunën e Gjakovës (KKSB), në këtë përbërje:

1. Ardian Gjini, Kryetar i Komunës, kryesues i KKSB-së
2. Milazim Lumi, anëtar - Komandant i Stacioni të Policisë në Gjakovë
3. Valon Myrta - anëtar - përfaqësues i Bashkësisë Islame
4. Aleksander Tanushi, anëtar - përfaqësues i Kishës Katolike
5. Leonard Shehu përfaqësues i Bashkësive të Tarikateve në Gjakovë
6. Jeton Sokoli, anëtar - përfaqësues i Bashkësisë Ungjillore
7. Nesemi Dervishdana, anëtar - përfaqësues i Tarikatit - Teqeve
8. Hysen Brahimaj, anëtar - Drejtor i Drejtorisë për Arsim
9. Haxhi Sejdiu, anëtar - përfaqësues i sektorit të emergjencave civile komunale
10. Vedat Shatri, anëtar - përfaqësues i FSK-së
11. Trumëza Lila Ukmata, anëtare - Zyrtare për Barazi Gjinore
12. Ifete Jakupi, anëtare - përfaqësuese e Komunitetit Boshnjak

13. Emrah Cermjani, Kryesuesi i Komitetit për Komunitete - përfaqësues i komunitetit Rom
14. Zana Tafashiku Tarani, anëtare – Kryetare e Këshillit të prindërve të nxënësve
15. Armend Behluli, anëtar - përfaqësues e ZKKK-së
16. Brilanda Ballata, anëtare përfaqësuese e personave me aftësi të kufizuar
17. Faton Canhasi anëtar - përfaqësuese për media
18. Ideal Zhaveli, anëtar - përfaqësues i OJQ-ve
19. Dukagjin Vesvesja, anëtar - përfaqësues i Komunitetit të Biznesit
20. Agron Shala, anëtar - përfaqësues për Rogovë
21. Lendrit Qeli, anëtar - përfaqësues i komunitetit Egjiptian
22. Fadil Podrimja, anëtar - përfaqësuese e komunitetit Ashkali
23. Bedrush Podrimja, anëtar - përfaqësues për Lagjen Kolonia
24. Ilir Ukshini, anëtar - përfaqësues për Cërmjan.

2. Në rast të mungesës së Kryesuesit të KKSB-së në ndonjë takim punë, takimin e kryeson Nënkryetari i Komunës, z. Famur Fetahaj.

3. Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) është organ këshillues për çështjet e sigurisë në bashkësi, më përfaqësim të gjerë nga të gjitha komunitetet dhe shoqëria civile të Komunës së Gjakovës, ndërsa anëtarët e këtij këshilli kanë mandat të njëjtë me anëtarët e Kuvendit të Komunës.

4. Detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të KKSB-së, organizimi i mbledhjeve, vendimmarrja, zëvendësimi i ndonjë anëtari, kompensimi, si dhe mbikëqyrja e punës së KKSB-së, janë të rregulluara me Udhëzimin Administrativ nr. 27./2012 MPB – 03/2012 MAPL, për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi.

Me respekt,